

Publicisti mitrovicas, Nexhmedin Spahiu ka thënë se ajo që heqë barrikadën psikologjike mes jugut e veriut të Kosovës nuk është Ura e Ibrit por është Xhamia e Ibrit.

“Zhurma rreth Urës së Ibrit është kamuflimi më i madh politik aktual në Kosovë? Përmes marrëveshjes në Brukselit, Beogradi tenton që ta kamuflojë çështjen e Xhamisë së Ibrit, e cila ishte xhamia me vjetër në Mitrovicë dhe që u dogj deri në themel nga forcat serbe në prill 1999”, ka deklaruar Spahiu.



Më tej ai ka shtuar se përmes projektit të BE-së dhe marrëveshjes në Bruksel me pretekstin e hapjes së Urës së Ibrit tentohet që në vend të Xhamisë së Ibrit të bëhet fushë basketbolli ose lulishte në mënyrë që kushdo që do e ngrejë çështjen e rindërtimit të Xhamisë së Ibrit të merr përgjigjen se ky është projekt evropian dhe marrëveshje e Brukselit.



“Në fakt ajo që heqë barrikadën psikologjike mes Jugut e Veriut nuk është Ura e Ibrit por Xhamia e Ibrit,” ka theksuar Spahiu.

“Politikanët tanë nuk po merren me xhaminë nga frika se mos po etiketohen si fundamentalistë, kurse hoxhallarët tanë kanë frikë se duke u marrë me xhaminë që e dogjën ortodoksët serbë, po u zbehet fushata e tyre e pakuptimtë kundër katolicizmit dhe shiizmit”, ka shkruar Spahiu në FB. /tesheshi.com/